




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Zyrtari Përgjegjës për Prokurim Publik, bazuar në nenin 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.03.2018, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: " Studio Hapsira "sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Hartimi i projekteve ", me Nr. të Prok: 644 – 18 – 001 – 221, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të: " Studio Hapsira "sh.p.k. e dt. 13.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Hartimi i projekteve ", me Nr. VU644 – 18 – 001 – 221, Nr. Brendshëm: 644 – 18 – 121 – 221, kundër vendimit të A.K. lidhur me Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës : 06.03.2018, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Vërtetohet vendimi i AK për Anulimin e aktivitetit të prokurimit i publikuar në Web faqen e KRPP-s, më datë: 09.03.2018.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e dërgimit palës.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që të Anuloi aktivitetin e prokurimit: " Hartimi i projekteve " me nr. prok. :644 – 18 – 001 – 221, me arsyetimin sikurse është theksuar në Njoftimin e publikuar në Web faqen e KRPP-s.

Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë i është dërguar, përmes platformës elektronike, të gjithë Op. Ek. pra edhe " Studio Hapsira "sh.p.k., më dt. 08.03.2018.

Në Kërkesën për rishqyrtim të Njoftimit për Dhënie të Kontratës, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, Ankuesi konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (në tekstin e mëtejme LPP-së)Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-diskriminimi, paragrafi 1,2,3 dhe 4, neni 11 Mjetet për promovimin e Transparencës, neni 27 Dosja e tenderit, paragrafi 1 dhe 10, neni 62 Përfundimi i aktivitetit të prokurimit neni 1 paragrafi 1.1. dhe neni 2 paragrafi 2.1 si dhe nenin 44.7, 44.8 dhe 44.9 – Ndërprerja e procedurave të prokurimit, të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, duke specifikuar se, citat : " Bazuar në arsyetimin e A.K. për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për shkak të gabimeve teknike, nuk mundë të konsiderohet një shkelje ligjore pasi gabimet në Specifikacion Teknik kanë mundur edhe të korrigohej përmes formularit për korrigjim, tri ditë para hapjes së ofertave e jo pasi të hapen dhe të zbulohet çmimi i ofertuesve, në këtë rast jemi dëmtuar. Ky veprim për ne konsiderohet i papranueshëm me tendenca favorizimi, pasi ne jemi ofertues i shpallur i përgjegjshëm me çmimin e renditur lartë(çmimi më i ulët) mbarim i citatit. Me këtë rast A.K. ka bërë shkelje të procedurave të cilat janë paraparë sipas nenit 44.7, 44.8 dhe 44.9 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Më tej Ankuesi shton se mos nënshkrimi i kontratës i shkakton humbje të drejtpërdrejta kompanisë në vlerë 50.000,00€ duke përfshirë pagesat e marrëveshjeve me stafin, shpenzimet administrative, dëmtim të imazhit dhe performancës së kompanisë.

A.K. pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.: " Studio Hapsira "sh.p.k. është e pabazë, për arsye se:

Njësia Kërkuese, e cila është inicuese e kërkesës për prokurim, në bazë të përgjegjësiive të saja ligjore, ka përgatitur dhe propozuar Specifikimet teknike si dhe Paramasën dhe Parallogarinë për aktivitetin e prokurimit" Hartimi i projekteve" Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, Komisioni profesional dhe njësia Kërkuese kanë ardhur në përfundimin se në dosjen e tenderit te përgatitur nga A.K. te pjesa A- Aneksi Nr. 1 - Specifikacioni i detyrueshme teknik janë përvjedhur disa gabime te cilat rezultojnë - rrjedhin nga Kërkesa e Njësisë Kërkuese, sikurse janë:

- Pozicioni 1.4 Punimi i Projektit - Elektri, Instalimet e Kablove, LAN, IT, TV & Rrufe mbrojtësi dhe Pozicioni 1.5 : Punimi i projektit - Elektri, rrymat e dobëta dhe Video monitorim), duhen te përfshihen ne një

pozicion te vetëm, mare parasysh se ne shumicën e ndërtimeve te dyja fazat janë te domosdoshme dhe paraqitja grafike e këtyre dy pozicioneve është e lidhur me njëra tjetrën, që i bie se këto dy pozicione janë në kolaborim te plotë në mes vete. Krahas kësaj në rast se njëra nga këto dy pozicione është e panevojshme në projekt, atëherë projektuesi e paraqet vetëm njërin pjesë grafike te fazës se elektrikes.

Pozicioni 1.5 - Punimi i projektit Makinaria, projekti i instalimit te ngrohjes dhe pozicioni 1.6 punimi i projektit Makineri, projekti i instalimeve te ventilimit dhe kanalizimit, vlen arsyeya e njëjtë si ne pozicionin e elektrikes.

Andaj duke u bazuar në këto të gjetura, Komisioni i Vlerësimit të ofertave, si organ profesional, në konsultim me drejtorinë përkatëse – Njësinë kërkuese, me shkresën – Kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë Komunale për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit, si Njësi Kërkuese, kanë konfirmuar gabimet në Kërkesën e Tyre, të paraqitura ne Aneksin 1 te Sepcifikave Teknike duke kërkuar ne te njëjtën kohë me shkrim edhe anulimin e aktivitetit te prokurimit, me synimin që të eliminohen shpenzimet e panevojshme që do të dëmtonin buxhetin e A.K., pasi që, sikurse është konstatuar në Kërkesën e Njësisë Kërkuese, po qese vazhdohet me këtë përshkrim puna e inxhinierit të elektrikes dhe makinerisë po duhet të paguhet dy herë.

Duke vlerësuar si të arsyeshme Kërkesën e parashtruar nga Njësia Kërkuese, A.K., në bazë të dispozitave të nenit 62 pika 1 paragrafi 1.1. të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe Ligjin nr. 05/L-068, duke marrë parasysh edhe parimin e ekonomicitetit, efikasitetit si dhe obligimin ligjorë që ka për të siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë në konsideratë dhe qëllimin dhe lëndën e prokurimit ka vendosur të anuloi në tërësi aktivitetin e prokurimit

Pretendimet e parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim të vendimit të A.K. se me këtë vendim A.K. ka shkelur dispozitat e nenit 7 dhe 10 të LPP-së, Trajtimi i barabartë dhe / ose Mos diskriminimi dhe Promovimi i Transparencës, u vlerësuan të jenë të pabazuara për arsye se neni 62 pika 1.1. e LPP-së dhe neni 44.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik qartë theksojnë se A.K. duhet të përfundoj një aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultoi me dhënien e kontratës në rastin kur vlerësohet se, citat: "***një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit***". Duke vendosur në këtë mënyrë A.K. në asnjë rrethanë nuk ka shkelur, nenin 7 të LPP-së, parimin e trajtimit të barabartë të Op. Ek. për faktin se ky vendim ka efekte për të gjith Op. Ek. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, duke mos reduktuar apo eliminuar konkurrencën në mes Op. Ek. si dhe duke mos diskriminuar në dëm ose në të mirë të një ose më shumë Op. Ek.

Gjithashtu A.K. vlerësoi se me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë ka pasur transparencë të plotë për faktin se është bërë publikimi i Njoftimit për Kontratë, është siguruar qasja në dokumente për gjitha palët e interesuara, të gjithë Op. Ek. pjesëmarrës në këtë aktivitet janë informuar me shkrim, në mënyrë të barabartë dhe në kohë për gjithë rrjedhën e procesit dhe të vendim marrjes.

Në rastet e anulimit të aktivitetit të prokurimit të bazuara në dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe nenit 44.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik A.K. nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tenderuesve për anulimin e një procedura të prokurimit, në lidhje me kompensimin e Ankuesit, andaj pretendimet e Ankuesit për shkaktim të humbjeve të drejtpërdrejta atij në vlerë prej 50.000,00€ janë tërësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë.

Pretendimet tjera të parashtruesit të Kërkesës për Rishqyrtim, të paraqitura në Kërkesë, sikurse janë shkelja e rregullave të saktësuar në Dosjen e Tenderit, neni 1 dhe 10 si dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit, u vlerësua të dalin jashtë jurisdikcionit të A.K. dhe si të tilla u vlerësuan të mos jenë esenciale për të vendosur ndryshe përveç kësaj që është thënë në këtë vendim.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv te këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim - OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 001/2018 - datë 16/03/2018

Aktvendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Zyrtari Përgjegjës për Prokurim Publik


Hyda Dallku